

KONTRATË-DHURIMI

- (KUOTA SHOQËRI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR)-

Sot, në Tiranë, më datën 03/gusht/2020 (dymijë e njëzet), palët:

Bujar Tuku, i biri i Subiut, i datëlindjes 11.10.1956, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga "Haxhi Kika", P.141, shk.1, Apt.7, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal F61011022G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili më poshtë do të referohet "Dhuruesi";

dhe

Elvana DESHATI, e bija e Fariut, lindur në Kukës më 01.08.1973 dhe banuese në Tiranë, Rruga Siri Kodra, Pallati Agolli, Shk.1, Apt.8, madhere me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. Personal H35801199T, i cili më poshtë do të referohet "Pranuesja Dhurimit";

KUSHTE PARAPRAKE

Bujar TUKU, me cilësinë ortak i vetëm i shoqërisë "ABC HOME" sh.p.k., i regjistruar në QKB, me NIPT L82112052A, zotëron 1 (një) kuotë të shoqërisë me një vlerë prej 51 (pesëdhjetë e një) lekë, , të nënshkruara dhe të shlyera tërësisht.

Dhuruesi është i interesuar dhe ka pranuar që t'i dhurojë Pranuesit të Dhurimit 1 (një) kuotë të shoqërisë me një vlerë prej 51 (pesëdhjetë e një) lekë të kapitalit.

Pranuesja e Dhurimit, Elvana DESHATI konfirmon mirënjohjen për këtë akt bujar të Dhuruesit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë.

Në kuadër të kushteve paraprake të evidentuara më sipër, palët bien dakort të lidhin këtë kontratë dhurimi kuotash, si më poshtë:

NENI 1-OBJEKTI I KONTRATËS

Më anën e kësaj kontrate, palët kanë si qëllim të përcaktojnë kushtet dhe termat, sipas të cilave, Dhuruesi, Bujar TUKU konfirmon dhurimin në favor të Pranueses së Dhurimit, Elvana DESHATI, 1 (një) kuotë të shoqërisë me një vlerë prej 51 (pesëdhjetë e një) lekë, që në total përfaqësojnë 51 % të kapitalit të shoqërisë, si dhe t'i kalojë Pranuesit, cdo të drejtë që buron nga kuotat e përcaktuara në këtë kontratë, ndërsa Pranuesja zotohet t'i pranojë këto kuota të kapitalit.

NENI 2 - VLERA E SENDIT TË DHURUAR

2.1 Dhuruesi bie dakord t'i dhurojë dhe t'i transferojet Pranuesit dhe ky pranon 1 kuotë të kapitalit të shoqërisë objekt kontrate, me vlerën prej 51 (pesëdhjetë e një) lekë.

2.2 Palët konfirmojnë se ky dhurim kryhet pa kurrfarë interesit të tanishëm apo të mëvonshëm, barrë apo detyrimi ndaj të tretëve.

NENI 3 - TRANSFERIMI I KUOTAVE

Transferimi i kuotave objekt kontrate do të bëhet efektiv, me regjistrimin e kësaj kontrate në Regjistrin e Kuotave të Shoqërisë, si edhe në QKR Tiranë.

NENI4- DEKLARIMET DHE GARANCITË E DHURUESIT

4.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton se:

- a) Është pronar i vetëm ligjor dhe përfitues i vetëm i kuotave të përshkruara në këtë kontratë.
- b) Kuotat objekt kontrate janë shlyer plotësisht.
- c) kuotat janë të lira nga cdo lloj barre, pengu apo detyrimi tjetër dhe Dhuruesi ka të drejta të plota, pushtet dhe autoritet për t'i transferuar ato, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate Dhurimi.

4.2 Dhuruesi garanton Pranuesen e Dhurimit se në momentin e ekzekutimit të kësaj kontrate në regjistrin e kuotave të anëtarësisë së shoqërisë së thjeshtë dhe në QKB:

- a) Kuotat objekt kontrate, i jepin Pranueses titullin e pakthyeshëm të pronësisë mbi këto kuota si dhe cdo të drejtë tjetër që lidhet me zotërimin e tyre;
- b) Dhuruesi humbet pronësinë dhe nuk do të ketë më asnje të drejtë mbi 1 kuotë objekt kontrate.

NENI 5-LIGJI I ZBATUESHËM

Të drejtat dhe detyrimet e palëve të kësaj kontrate do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me legjisacionin Shqipëtar, posacërisht Kodi Civil i RSH, Nenet 761 e vijues...

NENI 6 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhen ndërmjet palëve me mirëkuptim dhe nëse nuk arrihet kjo, mosmarrëveshjet do të zgjidhen në rrugë gjyqësore, duke përcaktuar si gjykatë kompetente, Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

NENI 7 - FORCAT MADHORE

Asnjë prej palëve nuk do të konsiderohet përgjegjës në qoftë se mospërmbushja e detyrimeve kontraktore është rrjedhim i forcës madhore. Do të konsiderohen si forca madhore: revolucionet, kryengritjet popullore, luftërat, grevat, zjarret, përmbytjet, tërmetat si edhe ndërhyrjet dhe veprimet e shtetit që kufizojnë lirinë personale apo ato të ndërmarrjes të seciles palë.

NENI 8 - TE NDRYSHME


8.1 Kjo kontratë e shkruar përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve, përsa i përket objektit të kësaj kontrate dhe zëvëndëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, verbale apo të shkruara dhe të gjitha komunikimet e tjera të mëparshme ndërmjet palëve në lidhje me objektin në fjalë.

8.2 Me përashtim kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, cdo ndryshim i kësaj kontrate mund të bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.


8.3 Të dyja palët janë dakord se afatet dhe kushtet e kësaj kontrate janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen para një pale të tretë, përvèc sa kërkohet ligjërsiht sipas ligjit në fuqi.

8.4 Kjo kontratë është përpiluar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha të nënshkruara nga palët.

DHURUES


Buj/Buj

PRANUESE E DHURIMIT


Dherdh/Dherdh